



**2021**  
**Raporti**  
**Vjetor**

---



# Raporti Vjetor





## 2021

---

Të nderuar partnerë dhe miq të Caritas Kosova, në këtë raport vjetor gjeni informacion mbi aktivitetet e zbatuara në mbështetje të personave në nevojë gjatë vitit 2021.



# Përmbajtja

	Home Care/Përkujdesi Shtëpiak _____	8
	Mbështetja e shërbimeve Ambulatore _____	10
	C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë _____	12
	Bamirësia dhe Solidariteti _____	13
	SOCIETIES _____	14
	Ndalo dhe Ndhimo _____	16
	Kuzhina Popullore _____	17
	ELBA dhe Employ Yourself _____	18
	Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës _____	19
	YourJob _____	21
	Praxis _____	23
	Kopshti Engjujt _____	24
	My Right – Qendra e Edukimit të Hershëm _____	26
	Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian _____	28
	ABC EUAV – Shoqërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve _____	31
	Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19 _____	32
	CONEX _____	33
	Buxheti Vjetor _____	35

## Kush jemi Ne!

Caritas Kosova është institucion i Kishës Katolike në Kosovë misioni i së cilës është promovimi i paqes, solidaritetit, dhe dashurisë në mes të njerëzve. Caritas Kosova është anëtare e Caritas Internationalis dhe Caritas Europa që shërben dhe ofron ndihmë për më të varfërit pa dallim gjinie, race, kombësie, religjioni, etj.

Aktiviteti i Caritas Kosova në vitin 2021, në përputhje me strategjinë, ishte zbatimi i programeve dhe projekteve në kuadër të pesë fushave strategjike:

- Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore;
- Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social;
- Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit;
- Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor;
- Ndihma në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve.

Nëpërmjet veprimeve të shumta, jemi përpjekur të jemi në afërsi të atyre që janë në nevojë për të lehtësuar problemet në të cilat ata jetojnë, siç janë varfëria dhe izolimi.

## Udhëheqja jonë!

President i Caritas Kosova është Mons. Dodë Gjergji - Ipeshkëv i Kosovës, ndërsa Drejtor Gjeneral është Don Viktor Sopi.

## Të dashur bashkëpunëtorë



Caritas Kosova si institucion bamirësie në Kosovë vazhdon të luaj rolin e vet kyç në përkrahjen e personave në nevojë. Këtë e bëjmë duke analizuar me kujdes gjendjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve dhe duke u munduar të shfrytëzojmë çdo mundësi që na jepet për të qenë në shërbim të tyre.

Që nga themelimi në vitin 1992, Caritas Kosova është angazhuar për të përkrahur njerëzit në nevojë dhe për të realizuar fokusin e saj në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Vendi ynë vazhdon të përballlet me shumë sfida të cilat kanë ndikim në vetë ekzistencën e shumëkujt, sfida që rrezikojnë dhe dobësojnë ecjen e njeriut drejt qëllimit primarë, për të pasur një jetë të mirë, në paqe dhe në bashkëpunim me njëri tjetrin. Për këtë arsye Caritasi përpiqet që të ndikoj drejtpërsëdrejti në mbrojtjen dhe promovimin e dinjitetit njerëzor i cili është i pacënuar dhe paraqet epiqendrën e veprimit tonë duke u konkretizuar në promovimin e drejtësisë sociale dhe fuqizimin e të nëpërkëmburve që të realizojnë të drejtat e tyre themelore në të gjitha fushat e zhvillimit njerëzor.

Edhe gjatë vitit 2021 Caritas Kosova ka vazhduar me zell zbatimin e projekteve të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, i përkrahur nga Partner kombëtar dhe ndërkombëtar me të cilët kemi bashkërenduar aktivitetet për t'ju përgjigjur sa më mirë nevojave të cilat i hasim në teren gjatë punës sonë të përditshme. Në vazhdimësi jemi të përkushtuar që të zbatojmë masat e duhura për të fuqizuar komponentën sociale në vend, duke ofruar përvojën, profesionalizmin dhe vullnetin tonë të mirë në ofrimin e shërbimeve për kategoritë e caktuara si dhe ofrimin e përkrahjes për të siguruar përfshirje sociale, zhvillim të qëndrueshëm dhe edukim adekuat.

Po ashtu, edhe gjatë këtij viti, Caritasi i ka kushtuar vëmendje të posaqme zhvillimit organizativ dhe avansimit profesional si një aspekt i rëndësishëm i veprimit tonë që siguron qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të shërbimit. Një falenderim të përzemërt shprehim për të gjithë ata që angazhohen në Caritas Kosova që njeriut në nevojë i kthejnë buzëqeshjen, e përkrahin, e bëjnë të ndjehet i rëndësishëm, i fuqizuar dhe i trajtuar me dinjitet.

Zoti ju bekoftë!

**Don Viktor Sopi** – Drejtor Gjeneral



## Home Care/Përkujdesi Shtëpiak

Home Care apo projekti i përkujdesit shtëpiak që ka dy komponente kryesore, shërbimet shëndetësore dhe ato sociale për të moshuarit e vetmuar dhe për personat me regjim shtrati, është një projekt i veçantë i Caritas Kosovës në kuadër të sektorit të Përkujdesit, i cili zbatohet në bashkëpunim dhe bashkërendim të veçantë me institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky projekt është i hartuar dhe zbatohet në atë mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të grupeve të marginalizuara në Kosovë. Sidomos gjatë vitit 2021, duke parë nga afër situatën e rënduar sociale, shëndetësore dhe ekonomike të personave të sëmurë dhe të moshuar dhe pas identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të çdo individi, kemi ofruar shërbimet sociale dhe shëndetësore në shtëpitë e përfituesve me një bashkëpunim dhe koordinim edhe me

institucionet tjera sociale dhe shëndetësore në nivel vendi. Ofrimi i shërbimeve sipas këtij koncepti edhe këtë vit ka qenë i domosdoshëm për shkak të specifikave të projektit dhe gjendjes së rënduar shëndetësore nga pandemia Covid-19 si dhe për shkak të lidhshmërisë së shërbimeve sociale dhe shëndetësore që ofrohen tek përfituesit.

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore, sipas konceptit Home Care, ka pasur për qëllim që t'u përgjigjet nevojave më elementare sociale, shëndetësore dhe psikologjike që kishin të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara gjatë vitit 2021.

Shumë nga të moshuarit, përfitues të projektit, vazhdojnë të jenë të vetmuar dhe të braktisur nga familjarët e tyre dhe nga shoqëria, dhe fatëkeqesisht nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për të realizuar jetë dinjitoze.







Projekti Home Care ka ndikuar që jeta, mirëqenia dhe shëndeti i personave të moshuar dhe të vetmuar të përmirësohet si rezultat i ofrimit të kujdesit social dhe shëndetësorë gjatë gjithë vitit. Po ashtu, projekti ka ndikuar që përfituesit e projektit, si dhe familjarët e tyre, të mbrohen nga mundësia e infektimit me Covid-19, duke qenë se shërbimet në fjalë janë ofruar në shtëpitë e tyre. Home Care ka pasur ndikim

pozitiv edhe në punësimin e stafit profesional, të cilët janë të licencuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku përmes angazhimit në projekt kanë krijuar përvojat e tyre të para në punë. Asistenca me pako ushqimore dhe materiale higjienike për të moshuarit e vetmuar dhe të sëmurë, ka qenë e vazhdueshme.

**1430 persona të moshuar dhe të sëmurë si dhe 142 persona me aftësi të kufizuar, kanë pranuar 57980 shërbime shëndetësore dhe sociale në shtëpi, sipas konceptit të Home Care gjatë vitit 2021. Po ashtu, 182 persona janë përkrahur me shtretër, karroca, shetitore, ulëse tualeti, etj.**



## Mbështetja e shërbimeve Ambulatore



Përmes këtij angazhimi, respektivisht ofrimit të shërbimeve ambulatorë, Caritas Kosova synon jo vetëm funksionalizimin e punkteve shëndetësore në lokacionet ku mungon shërbimi i tillë, por edhe ofrimin e shërbimeve për popullësinë apo shtresën më të varfër e cila ka qasje të kufizuar ose asnjëfare në shërbimet ambulatorë. Kjo gjithashtu rrit edhe mobilitetin e vet përfituesve, duke rikthyer besimin në vlerat njerëzore të solidaritetit.

Ofrimi i shërbimeve të kombinuara shëndetësore dhe sociale, në ambulanta të ndryshme gjatë vitit 2021, përveç që ishte e nevojshme, u shëndrrua në një mision të vështirë por të arritshëm për Caritas Kosova për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19. Edhe në vitin 2021 pati një kërkesë të shtuar për shërbime shëndetësore dhe sociale të cilat ishin tema kryesore e shoqërisë, në kohën kur shëndeti mori vëmendjen kryesore. Prandaj, si rezultat i situatës shëndetësore të ndikuar nga pandemia, Caritas Kosova ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të gjitha aktivitetet shëndetësore dhe sociale të bëhen në koordinim me institucionet publike dhe sipas rekomandimeve dhe vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës.

Në kuadër të këtij angazhimi, Caritas Kosova ka mobilizuar tërë stafin shëndetësorë në 12 Komuna të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Viti, Fushë Kosovë, Shtime, Suharekë, Istog, Malishevë dhe Junik. Në secilën komunë respektive, Caritas Kosova ka ofruar shërbime shëndetësore dhe sociale duke u munduar që të kontribuoj në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen nga infektimi me Covid-19 si pjesë e ekipeve emergjente komunale në luftën kundër Covid-19.



Gjatë vitit 2021, në kuadër të shërbimeve ambulatore, kemi ofruar mbi 1,4 milion shërbime shëndetësore dhe sociale për 411134 përfitues.



Partnerët: Komunat - Prizren, Ferizaj, Gjilan, Viti, Fushë Kosovë, Shtime, Suharekë, Istog, Malishevë, Junik.



## C.I.K. Ambulanca Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë

Në kuadër të përkujdesit shëndetësor Caritas Kosova ka edhe ambulancën specialistike të mjekësisë familjare dhe ambulancën e stomatologjisë në Dubravë të Ferizajt. Kjo ambulancë funksionon në hapësirat e Qendrës Sociale Edukative 'Caritas Kosova' dhe ofron shërbime shëndetësore pa pagesë për banorët e fashatit Dubravë. Ambulanca është e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, ka staf profesional mjekësor si dhe pajisjet e nevojshme medicinale

dhe prezenca e saj në këtë lokalitet është e një rëndësie të veçantë marrë parasysh nevojën e komunitetit si dhe rëndësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore sa më pranë tyre. Aktualisht Ambulanca funksionon me orarë të plotë dhe përveç shërbimeve shëndetësore luan një rol shumë të rëndësishëm në shpërndarjen e informacioneve dhe ngritjen e vetëdijes së fëmijëve që frekuentojnë Qendrën mbi rëndësinë e parandalimit dhe trajtimit shëndetësor.

**Në kuadër të Ambulancës Specialistike, gjatë vitit 2021, kemi ofruar shërbime shëndetësore dhe stomatologjike pa pagesë për banorët e Dubravës. Po ashtu, në kuadër të Home Care, kemi ofruar shërbime sociale dhe shëndetësore për 103 persona të moshuar dhe të sëmurë.**



## Bamirësia dhe Solidariteti

Që nga fillet e para të angazhimit të Caritas Kosova, asistenca sociale për familjet që jetojnë në varfëri ekstreme ka qenë një nga objektivat kryesore.

Gjatë vitit 2021 janë ndihmuar shumë familje me ndihma në ushqim, veshmbathje, mobilje, etj. Po ashtu, një ndihmë e madhe ju ka dhënë edhe shoqatave të ndryshme të cilat

punojnë me familjet e varfra. Në vitin 2021 janë shpërndarë 81.14 ton me ndihma humanitare.

Ky projekt paraqet një angazhim të vazhdueshëm të Caritas Kosova dhe është i mundur falë bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, sidomos me Junge Leute Helfen nga Gjermania, të cilët na mbështesin me ndihma humanitare.

*Partnerët: Junge Leute Helfen, Malteser, Bamirësit*





## SOCIETIES



Projekti SOCIETIES, faza 2, ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve, përgjegjësinë dhe efektivitetin e OShC-ve në menaxhimin e iniciativave të përfshirjes sociale dhe de-institucionalizimit si dhe në promovimin dhe avokimin për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me standardet e pranimit në Bashkimin Evropian.

Periudha e fillimit të projektit u afektua nga përballja globale me pandeminë Covid-19 dhe kjo situatë shkaktoi shumë sfida në zbatimin e projektit duke shkaktuar sfida në zbatimin e aktiviteteve sipas planifikimit.

Gjatë vitit 2021 projekti zhvilloi aktivitete lidhur lidhur me skemen e nëngranteve në kuadër të programit të ngritjes së kapaciteteve për OShC-të, si dhe aktivitete për monitorimin e tyre.

Ky vit, si rezultat i masave mbrojtëse më të lehta në lidhje me pandeminë, mundësoi zhvillimin e vizitës studimore në Mal të Zi.

Kjo vizitë u zhvillua në periudhën 21-24 qershor në Bar të Malit të Zi dhe u organizua nga Caritas Montenegro. Programi ishte i fokusuar në praktikat më të mira të përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në Mal të Zi, respektivisht në Bar, Podgoricë dhe Tuz, si dhe në praktikat e mira për shërbimet e ofruara pranë autoriteteve lokale dhe kombëtare. Nga Kosova, përveç Caritas Kosova, morën pjesë organizatat: Handikos, Autizimi, Duart Plot Mëshirë si dhe organizata partnere në projekt Qendra për Jetë të Pavarur.



Gjatë vizitës pjesëmarrësit patën mundësi të shohin projektet e ndryshme inovative sociale për personat me aftësi të kufizuara të drejtuar nga OJQ-të në Mal të Zi si dhe shërbimet dhe politikat e drejtuar nga autoritetet lokale dhe kombëtare.

Është organizuar trajnimi për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve në temat: menaxhimi social, ngritja e fondeve dhe planifikimi strategjik. Gjithsej 19 pjesëmarrës nga 9 OSHC (5 OSHC nga Kosova dhe 4 OSHC nga Shqipëria)

patën mundësi që të trajnohen në modulet e sipër përmendura, si disa nga aspektet më të rëndësishme në punën e tyre.

Gjatë këtij viti është krijuar task-forca për avokim e cila përbëhet nga anëtar të OSHC-ve dhe Institucioneve relevante dhe ka për qëllim përmirësimin dhe ofrimin e dialogut ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve relevante në lidhje me trajtimin e sfidave në këtë fushë si dhe kontributin për kornizën ligjore.





## Ndalo dhe Ndihamo

Përmes projektit STOP AND HELP/NDALO DHE NDIHMO, Caritas Kosova angazhohet për përmirësimin e parandalimit të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore, për të avancuar protokollet dhe mjetet e ndërhyrjes dhe për të ngritur në një nivel më të lartë sistemin e shërbimeve të referimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje. Në këtë mënyrë projekti mbështet betejën e vazhdueshme kundër këtyre akteve kriminale të dhunshme që po ndodhin gjithnjë e më shumë. Ky veprim, po i mundëson Caritas Kosova si organizatë zbatuese, të arrijë ndikim pozitiv në numrin më të madh të mundshëm të anëtarëve të grupeve të synuara, duke marrë parasysh rëndësinë e ndikimit shkatërrues të problemit në fjalë. Projekti zbatohet në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan, Mitrovicë Veriore dhe Mitrovicë Jugore.

Veprimet dhe shërbimet e projektit, gjatë vitit 2021, iu dedikuan betejës kundër akteve të dhunshme që po ndodhin gjithnjë e më shumë, veçanërisht gjatë problemeve globale shëndetësore. Seancat informative, kampanja e organizuar me kujdes, materialet sensitive promovuese të të drejtave të viktimave, ofrimi i materialit bazë të drejtpërdrejtë dhe ndihma mjekësore sjellin një ndjenjë shprese dhe lehtësimi për viktimat dhe të gjithë anëtarët e familjes.

Në mënyrë direkte janë mbështetur 4 viktimat si dhe 15 anëtarë të familjeve të tyre. Ndërsa përfitues indirekt të aktiviteteve të projektit gjatë këtij viti kanë qenë 496 persona të mbështetur me ndihma humanitare.



Partnerët: Bashkimi Evropian, Save the Children International në Kosovë





## Kuzhina popullore

Në fund të vitit 2021, në Prishtinë, Caritas Kosova ka filluar me projektin e kuzhinës popullore për ofrimin e shujtave ushqimore ditore për personat e varfër. Prishtina si kryeqendër urbane me popullsi të madhe, rrjedhimisht ka edhe shumë persona që përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale. Sidomos të moshuarit dhe personat tjerë të vetmuar, vazhdojnë të jenë një nga grupacionet më në nevojë dhe të cënuar në çështjen e sigurimit të ushqimit.

Përmes këtij projekti dhe mbështetjes nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Caritas Kosova ka qenë në gjendje që përmes ri-funksionalizimit të kuzhinës popullore të ju përgjigjet kërkesave të shumta për shujta ditore të atyre që në periudhë pandemie e kanë edhe më të vështirë sigurimin e ushqimit.

Gjatë muajit dhjetor, përveç shujtave të ofruara në kuzhinën popullore, janë ofruar edhe shujta të ngrohta në shtëpitë e të moshuarve, sidomos për ata me regjim shtrati për shkak të sëmundjeve.



Partnerët: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve



## ELBA dhe Employ Yourself

ELBA (Emergency Labour in Balkans) dhe Employ Yourself janë iniciativa të projektuara për t'iu përgjigjur krizës ekonomike në Evropën Juglindore dhe pjesë të këtij projekti janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia Veriore. Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin publik si dhe sektorin privat, nga organizata fitimprurëse tek organizatat jo-fitimprurëse, nga territoret tek komunitetet, për të zhvilluar një model të ri ekonomik që përfshin njerëzit në nevojë si burim aktiv i shoqërisë.

Ekonomia sociale njihet si një mënyrë për të angazhuar dhe për të fuqizuar të gjithë shoqërinë, sektorin. Ajo që i bën ata

pjesë të ekonomisë sociale janë vlerat dhe veçoritë e përbashkëta që i bashkojnë, për shembull ata vendosin njerëzit mbi fitimet, qeverisen në mënyrë demokratike dhe riinvestojnë shumicën e fitimeve.

Gjatë vitit 2021 Caritas Kosova ka analizuar të gjitha mundësitë që të i'u del në ndihmë ndërmarrjeve sociale në Kosovë. Po ashtu, janë bërë edhe disa video inqizime për të promovuar punën e ndërmarrjeve sociale dhe të disa organizatave rinore.

Në vitin 2021, janë organizuar disa Webinar me tematika të ndryshme ku njëra ndër to ishte "Laudato Si" - Ndërtimi i një ekonomie të re dhe një shoqërie të re.

## CST and Social Economy Caritas Spain experience

**44** All the believers were together and had everything in common. **45** They sold property and possessions to give to anyone who had need.

(Acts 2, 44-45)



## Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës

Caritas Kosova është përqëndruar në fuqizimin dhe përkrahjen e të pa punëve drejt punësimit. Si rrjedhojë ky projekt është fokusuar në mënyrë të veçantë në mbështetjen e vetëpunësimit përmes trajnimit, mentorimit, rrjetëzimit, praktikës dhe mbështetjes materiale për gratë dhe të rinjtë e cenueshëm që kërkojnë një vend pune ose që janë të gatshëm për të filluar ose zhvilluar biznesin e tyre për gjenerimin e të ardhurave.

Logjika e ndërhyrjes së projektit bazohet në faktin se ka një mospërputhje ndërmjet nevojave të tregut për punësim dhe aftësive të punëkërkuësve. Kjo krijon një unazë ku sistemi i dobët arsimor, mungesa e fuqisë punëtore të arsimuar, papunësia dhe varfëria, ushqejnë njëri-tjetrin. Kjo është

veçanërisht e theksuar në rastin e grave dhe të rinjve, si dhe grupeve të diskriminuara siç janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Nga 250 aplikacione, 48 përfitues të përzgjedhur në bazë të kriterëve kanë marrur pjesë në trajnime të personalizuar rreth biznes planeve (27 gra dhe 21 të rinjë). Prej tyre, me një qasje shumë rigorozë është bërë përzgjedhja e 25 ideve të biznesit për të marrë grante fillestare.

Nga 120 përfitues të planifikuar fillimisht, në fund projekti ka arritur në 153 përfitues të cilët kanë marrë trajnime të certifikuara. 107 prej tyre ishin të rinj (përfshirë gratë e reja) dhe 46 ishin gra mbi 25 vjeçare.

“Askush nuk ua kishte dhënë këtë shans grave më parë. Kisha vetëm 4 vjet shkollë”. - Gruaja e cila ishte trajnuar përmes projektit në Ferizaj




Po ashtu, projekti ka arritur të mbështesë 52 praktikantë (39 të rinj dhe 13 gra) në 25 biznese lokale.

“Caritas më ka ndihmuar shumë. Për gjysmën e jetës sime kam fjetur, pa asnjë mundësi dhe perspektivë për jetën. Tani kam një ide se çfarë mund të bëj për veten time” - Përfitues i projektit.

Janë përkrahur dhe financuar 5 shoqata profesionale (3 në rajonin e Mitrovicës dhe 2 në rajonin e Ferizajt) në mënyrë

që të vazhdojnë punën me gratë dhe të rinjtë edhe pas përfundimit të projektit.

“Caritasi zgjodhi nismën tonë dhe na mbështeti. Synimi ishte që ne si organizatë vendore të forcohemi për të vazhduar punën për këto çështje. Qëllimi është arritur dhe ne shkuam përtej kësaj sepse projekti ka lënë pas një treg ku përfituesit do të vazhdojnë aktivitetin e tyre të biznesit”. - Organizatë përfituese



Partnerët: Bashkimi Evropian dhe Secours Catholique – Caritas France



## YourJob

Projekti YourJob i Caritas Kosova është projekt që ka për qëllim përgatitjen e të rinjve për tregun e punës. YourJob është duke u zbatuar në komunat: Prizren, Gjakovë, Viti, Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut dhe Kllokot. Përveç në Kosovë, YourJob zbatohet edhe në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi. Objektivi kryesor i projektit YourJob konsiston në mbështetjen e të rinjve nga moshja 15 vjeçare deri në moshën 30 vjeçare, në përgatitjen e tyre për një punësim sa më të qëndrueshëm.

Përgjatë vitit 2021 zbatimi i projektit YourJob ka vazhduar më një ritëm dhe intensitet shumë të lartë. Falë mbështetjes

nga zyra qendrore dhe në bashkëpunim me donatorët, në vitin 2021 projekti YourJob ka arritur objektivat e synuara dhe i ka tejkaluar ato, si nga numri i të rinjve që kanë përfituar dhe nga kualiteti i shërbimeve që ka ofruar.

Përgjatë vitit 2021, në projekt janë përfshirë mbi 1500 të rinjë. Po ashtu, përgjatë këtij viti, janë sistemuar në punë praktike mbi 50 të rinjë, 70% e të cilëve e kanë vazhduar punën edhe pas përfundimit të praktikës. Janë mbështetur në trajnime profesionale 80 të rinjë, kurse në trajnime online, kryesisht në shkathtësi të buta, rreth 50 të rinjë. Gjatë këtij viti janë shpërndarë 6 grante për hapjen e bizneseve nga të rinjtë.





Këto rezultate janë arritur falë rritjes së bashkëpunimit të Caritas Kosova me shumë institucione edukative arsimore dhe kompani e biznese të ndryshme. Gjatë vitit 2021, përmes projektit YourJob, Caritas Kosova ka nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani-biznese si: Universiteti Amerikan në Kosovë, Cactus Education, SEPEEEX etj.

Rezultate e arritura gjatë vitit 2021 kanë lënë gjurmë tek të rinjtë, të cilën janë falënderues ndaj përkushtimit të stafit të projektit për mundësinë e ofruar.

*"Shumicën e kohës mendoja se e kisha fatin e humbësit, pasi që refuzohesha vazhdueshëm. Derisa takova ekipin e YourJob. Ju keni ringjallur vullnetin tim për ndryshim. Jam i lumtur tani. Edhe familja ime është e lumtur. Jam i lumtur që si familje, nuk kemi nevojë për ndihma, pasi tashmë kamë përfituar punën përmes projektit YourJob" - tha Edon Emini nga Mitrovica, përfitues i punës praktike.*

Ndërsa Rrezarta nga Vitia, dukë përshkruar eksperiencën e saj me projektin YourJob, shprehet: *"Personalisht është një eksperience shumë e mirë duke mësuar dhe praktikuar gjëra të reja, e sidomos kur kjo ka qenë dhe vazhdon të jetë një dëshirë shumë e madhe e imja. Ju faleminderit shumë. Jam dhe do të jem gjithmonë shumë mirënjohëse ndaj jush.*

*Ju urojë të gjitha të mirat dhe suksese në punën tuaj. Jeni për çdo lëndëdate!". - Rrezarta përfituese e trajnimit në Dizajn Grafik.*

Në anën tjetër, pandemia po ashtu ka qenë një nga sfidat që ka përcjellur edhe vitin 2021, por përkundër kësaj, rezultatet nuk kanë munguar. Kjo vërehet edhe tek përfituesit të cilët përkundër pandemisë, kanë arritur të orientohen dhe punësohen apo të hapin bizneset e tyre. Elind Hajdari nga Prizreni i cili ka hapur punëtorinë e tij për të prodhuar mobilje, shprehet: *"Pikërisht në kohën kur pandemia shpërtheu, për mua u hap një rrugë për t'u aftësuar në fushën që gjithmonë kam dashur, të mësoja zanatin e mobilerisë në një kompani në Prizren, por prapë nuk kishte perspektivë që të vazhdoja të punoja këtu, vetëm se të ndërmerrja rrugën që shumë të rinj po e marrin, të lë vendin tim për një jetë më të mirë jashtë Kosovës. Falë Caritas Kosova, e gjithë ajo ide ndryshoi kahje, tash jam më shumë se i lumtur, sepse po bëj punën që gjithmonë kam dashur, më është bërë realitet ëndrra e të qenit sipërmarrës. Jam shumë falënderues që më ofruat këtë mundësi që të punoj dhe jetoj në vendin tim, ku do të vazhdoj të jem përkrahës i rinisë sonë, sepse bashkë edhe këtu mund ta bëjmë vendin si në Gjermani apo kudo tjetër në Evropë".*

## PRAXIS

Projekti PRAXIS është i definuar si një proces i cili bënë të mundur përdorimin e njohurive teorike në praktikë. Përkundër njohurive teorike të të rinjve, ende kemi një boshllëk të madh në mes tyre dhe tregut të punës, prandaj fokusi i PRAXIS në dimensionin praktik është përgjigje për nivelin e lartë të papunësisë së vajzave dhe djemve të rinj në Kosovë dhe Mal të Zi.

Ky projekt i'u dedikohet të rinjve dhe do t'ju siguroj atyre informacionet e duhura për vendimarrje më të mirë për orientimin profesional. Praktika dhe Edukimi janë mbështetja konkrete e këtij projekti që ju mundëson të rinjve të jenë me konkurent në tregun e punës.

Projekti PRAXIS gjatë vitit 2021 iu kushtua të rinjve të papunë në zbatimin e njohurive teorike në praktikë. Në komunat e Gjakovës dhe Klinës janë organizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të programit të orientimit në karrierë, mentorimit, praktikës dhe vullnetarizmit, fushatave të punësimi, trajnimeve për shkathtësitë e buta dhe panairit ndërkufitar të parë të punës në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

Fokusi kryesor i projektit ishte përgjigja ndaj nivelit të lartë të papunësisë së vajzave dhe djemve të rinj në Kosovë dhe Mal të Zi gjatë situatës pandemike. Në vijim të udhëzimeve dhe rekomandimeve të Qeverisë, disa nga aktivitetet u përshtatën nga zbatimi fizik në atë virtual duke mos reduktuar rëndësinë e arritjes së qëllimit. Pjesëmarrja aktive, krahas përfituesve dhe partnerëve, u ofrua nga të gjithë aktorët përkatës të përfshirë nga

sektori i punësimi në zonën ndërkufitare.

Në fund të vitit të parë, pëmes info sesioneve, trajnimeve, mentorimit, punës praktike, vullnetarizmit, panairit të punës, dhe rrjetëzimit, kanë përfituar 1220 përfitues direkt dhe 4840 përfitues indirekt.

Në përgjithësi, grupet e synuara treguan interes të madh për të marrë pjesë në aktivitetet e projektit, duke njohur mundësitë për zhvillimin e tyre dhe kualifikimet e përshtatura për tregun e punës.



*Partnerët: Bashkimi Evropian dhe Catholic Relief Services*



## Kopshti Engjujt

Në kuadër të programeve dhe projekteve të veçanta që zbaton Caritas Kosova, edukimi parafillor dhe menaxhimi i kopshteve për fëmijë është objektivë e rëndësishme e Caritas Kosova, prandaj edhe gjatë vitit 2021 Caritas Kosova ka menaxhuar me sukses kopshtin e fëmijëve "Engjujt" me qëllim të ofrimit të shërbimeve edukuese kualitative të kujdesit ditor për fëmijët të cilët kanë nevojë për mirëqenie dhe kanë nevojë që edukimi dhe socializimi i tyre të bëhet me një standard të lartë të edukimit dhe profesionalizmit.

Misioni i kopshtit është krijimi i një vendi të sigurt, të përshtatshëm, të ngrohtë dhe të planifikuar mirë, për fëmijët e moshës 06-6 vjeç, në përputhje me veçoritë individuale të secilit fëmijë.

Kopshti Engjujt, gjatë vitit 2021, ka ofruar shërbimet e kujdesit për 230 fëmijë. Kopshti Engjujt është i licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka lokacion shumë të përshtatshëm, hapësira gjelbëruese dhe objekt të modeluar posaçërisht për botën e këndshme të fëmijëve. Ne krijojmë avantazh në realizimin e planprogramit përmes aktiviteteve të cilat kërkojnë hapsirë adekuate, duke përfshirë këtu edhe hapsirat për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Partner: Komuna e Ferizajt





## My Right – Qendra e Edukimit të Hershëm

Projekti My Right/E Drejta lme ka në fokus fëmijët me aftësi të kufizuar, prindërit e tyre si dhe institucionet arsimore lokale. Ky projekt ka dy komponente kryesore në vetvete:

- Edukimin e Hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuar/Qendra e Edukimit të hershem për fëmijët 0-5 vjeç
- Gjithpërfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin e rregullt shkollor

Gjithsej 84 fëmijë janë mbështetur gjatë vitit 2021 në qendrën e edukimit të hershëm si dhe në institucionet shkollore. 41 fëmijë të moshës 0 deri në 6 vjeç mbështeten sistematikisht në baza ditore në Qendër. Orari i caktuar për çdo fëmijë shërben si plan pune. Bazuar në nevojat e PAK, oraret dhe planet e tyre janë përshtatur, që do të thotë se një fëmijë mund të marrë më shumë shërbime.

Mesatarisht 10 fëmijë në ditë mund të marrin shërbime në Qendër. Kështu, në baza javore mund të arrihet numri prej 41 fëmijë me aftësi të kufizuara që marrin shërbime. Pjesëmarrja e fëmijëve evidentohet përmes raportit javor të përgatitur nga stafi i Qendrës. Formularët e raportit plotësohen nga stafi i qendës në baza javore dhe përmbajnë shërbimet e ofruara për PAK. Gjithashtu, 22 fëmijë-të regjistruar në Qendër janë të pajisura me një plan individual tranzicioni, i cili shërben si ndjekje sistematike e zhvillimit të fëmijës gjatë një periudhe të caktuar.

Viti 2021 ishte shumë më i mirë sa i përket zbatimit të aktiviteteve të parapara në projekt në krahasim me vitin para-prak. Në raste kur kishte ndryshime të masave mbrojtëse kundër Covid-19 (që këtë vit ishin më të lehta), ekipi i Qendrës dhe ekipi i psikologëve nëpër shkolla, kishte në dispozicion planin online të punës, i cili është përdorur shumë pak sepse puna është bërë në Qendër.





## Përfshirja Sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Caritas Kosova punon intenzivisht në zhvillimin e projekteve për të përkrahur përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të këtyre komuniteteve. Duke u bazuar në gjendjen e rëndë socio-ekonomike, arsimore dhe kulturore të këtyre komuniteteve, Caritas Kosova ka fokusuar aktivitetet e saja në katër komponentë kryesorë, në Edukim, Kulturë, Shëndetësi dhe Asistencë Sociale. Përkundër intervenimit në shumë fusha këto komunitete vazhdojnë të përballen me probleme të mëdha, sidomos me papunësinë, mos përfshirjen, segregimin, infrastrukturën e pakët, etj.

### Qendra Sociale-Edukative “Caritas Kosova” – Dubravë, Ferizaj

Në Qendrën Sociale dhe Edukative të Caritas Kosova në Dubravë të komunës së Ferizajt, gjatë vitit 2021 janë ofruar shërbime të ndryshme për komunitetet që jetojnë aty, në total Qendra numroi 264 nxënës në të gjitha nivelet. Në edukimin parashkollor të nivelit 0 ishin 38 fëmijë, 16 vajza dhe 22 djem. Në mësimet plotësuese në nivelin 1, përgjatë vitit 2021 ishin 144 nxënës 83 vajza dhe 61 djem dhe në nivelin 2 ishin 82 nxënës, 49 vajza dhe 33 djem. Gjatë këtij viti, në mënyrë të veçantë janë përkrahur 30 fëmijë që kanë probleme të theksuara me shkrim dhe lexim.

Përveç shërbimeve edukuese, në Qendër janë ofruar edhe shërbime sociale. Punëtorja Sociale ka punuar në mënyrë individuale me 6 fëmijë të grupmoshave dhe gjinive të ndryshme.





Me një aktivitet shumë të veçantë është shënuar Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve me nxënësit e Qendrës Sociale Edukative "Caritas Kosova" në fshatin Dubravë. Marshi ka filluar nga Qendra duke marshuar nëpër fshatin Dubravë, për të përfunduar para ndërtesës së Komunës së Ferizaj. Qëllimi i këtij marshi ishte ndërgjegjësimi i prindërve, mësimdhënësve, qytetarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme për nevojën e respektimit të të drejtave të fëmijëve. Në kuadër të Qendrës është edhe C.I.K. Ambulanca

Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulanca e Stomatologjisë e cila ofron shërbime shëndetësore për qytetarët e Dubravës.

Në Qendër është ofruar edhe asistencë sociale përmes ndihmave humanitare në ushqim dhe veshmbathje, sidomos kur kemi parasysh që për shkak të pandemisë me Covid-19, nevoja për këtë asistencë ishte tejet e madhe. Përfitues direkt të kësaj mbështetjeje ishin banorët e Dubravës.

*Partner: Komuna e Ferizajt*





## Qendra Sociale-Edukative “Caritas Kosova” – Lagja Ali Ibra, Gjakovë

Caritas Kosova punon vazhdimisht në zbatimin e projekteve që përkrahin përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë tonë, rëndësi të veçantë i kushtohet edukimit të fëmijëve dhe përmirësimit të mirëqenies së tyre sociale.

Caritas Kosova në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës ka vazhduar përkrahjen e komunitetit Egjiptian në lagjen Ali Ibra në Gjakovë. Edhe përmes këtij angazhimi Caritas Kosova synon që të krijoj më shumë mundësi për përfshirje sociale, sidomos për fëmijët e këtij komunitetit, përmes aktiviteteve të ndryshme në fushën e edukimit, kulturës, sportit, etj.

Gjatë vitit 2021, në këtë Qendër, janë ofruar shërbime edukative dhe aktivitete psiko-sociale për fëmijët e moshës 4 – 15 vjeç. 167 fëmijë kanë pranuar në baza ditore shërbime në kuadër të mësimin plotësues. 45 fëmijë nga moshën 4 deri në 6 vjeç kanë ndjekur edukimin parashkollor, mësimin shtesë e kanë ndjekur 100 fëmijë të shkollave fillore, ndërsa 22 të tjerë kanë marrë pjesë në aktivitete psiko-sociale. Po ashtu, gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar edhe kampanja të ndryshme vetëdijësuese në lidhje me çështjet e arsimit dhe regjistrimit të fëmijëve në klasën e parë.

Partner: Komuna e Gjakovës

Në kuadër të Qendrës janë ofruar edhe shërbime shëndetësore si pjesë e projektit “Home Care” ku përgjatë vitit 2021 kanë pranuar shërbime shëndetësore mbi 100 të moshuar të komunitetit Egjiptian në lagjen Ali Ibra në Gjakovë.





## Mbështetja e përfshirjes sociale të fëmijëve nga Roma Mahalla, Mitrovicë

Gjatë vitit 2021, ky projekt që zbatohet në: Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Graçanicë dhe Shtërpcë, kishte këto objektiva kryesore: Rritja e vetëdijes së fëmijëve dhe prindërve të tyre për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve dhe rëndësinë e Ujësllësit dhe Kanalizimit (WASH) në gjashtë komuna të përzgjedhura (përfshirë Mahallën e Romëve në Mitrovicë); Prindërit e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë që jetojnë në Mahallën e Romëve, janë të vetëdijshëm për rëndësinë e përfshirjes sociale përmes shfrytëzimit të arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale; Së paku 80% e fëmijëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë demonstruar progres zhvillimor përmes zbatimit të programit të vizitave në shtëpi duke përdorur metodologjinë Portage; Së paku 80% e fëmijëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga Mahalla e Romëve do të

eksponohen ndaj shërbimeve parandaluese shëndetësore si imunizimi dhe largimi i parazitëve.

Për të rritur imunizimin në mesin e komuniteteve më të gjera, me theks të veçantë në grupet vulnerabël, u zhvilluan aksione promovuese përmes posterave dhe billbordeve promovuese në 6 komunat e synuara. Në total janë zhvilluar 4 video edukative që promovojnë rëndësinë e imunizimit në kohë. Gjithashtu, në kuadër të kontrolleve të rregullta mjekësore për fëmijët, këshillimoret e nënave dhe fëmijëve i kanë informuar prindërit për planin e rregullt të vaksinimit. Të gjitha aktivitetet e përmendura janë realizuar në gjashtë komunat respektive duke informuar më shumë se 11.000 familje për rëndësinë e imunizimit në kohë. Profesionistët e kujdesit shëndetësor gjatë sesioneve mjekësore vjetore kanë shpërndarë informacione dhe mesazhe të rëndësishme për më shumë se 1800 fëmijë parashkollorë.





Në 41 punëtori të organizuara në hapësirë të hapur 346 fëmijë kanë përfituar nga këto punëtori interaktive që mbulojnë tema kreative të cilat kanë kontribuar në procesin e socializimit të fëmijëve dhe tejkalimin e sfidave dhe vështirësive gjatë orëve online. Sfida e madhe ishte përfshirja e prindërve në seminare me fëmijë, veçanërisht gjatë pandemisë. Megjithatë, ekipi i projektit arriti të organizojë 10 punëtori të përbashkëta duke adresuar pyetjet mbi rëndësinë e zhvillimit të fëmijërisë së hershme, parandalimin dhe zakonet e shëndetshme, duke njohur simptomat e hershme të sëmundjeve të ndryshme infektive. 105 prindër

u informuan se si të realizojnë të drejtat në kujdesin shëndetësor, veçanërisht në lidhje me imunizimin e fëmijëve. Për të përmirësuar përfshirjen sociale të fëmijëve, ekipi i projektit ka realizuar 83 takime pune me përfaqësues të shkollave, institucioneve sociale dhe shëndetësore. Ekipi i projektit organizoi vizita për 780 familje duke i njohur prindërit me rëndësinë e imunizimit në kohë. Vizitat përfshinin gjithashtu mbështetje për sistemin shëndetësor në shpërndarjen e thirrjeve shtesë për vaksinimin e fëmijëve. Në këtë mënyrë ekipi i projektit ka ofruar mbështetje për institucionet e kujdesit shëndetësor në zbatimin e imunizimit më të gjerë.

Partner: UNICEF





## ABC EUAV – Shoqërimi dhe ndërtimi i kapaciteteve


Projekti ABC-EUAV zbatohet nga konsorciumi i nëntë organizatave të Caritas-eve nacionale në vendet e Evropës Lindore dhe Jug-Lindore me objektivin e përgjithshëm të rritjes së kapaciteteve ekzistuese organizative në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat dhe gatishmërisë së emergjencave, si dhe krijimin e sistemeve efektive dhe efikase të menaxhimit vullnetar. Ky projekt udhëhiqet nga aplikanti kryesor Caritas Europa. Projekti synon të krijojë mënyrat më efikase për të ndarë njohuritë rreth EUAV (metodologjitë, mjetet dhe praktikat më të mira). Partnerët mësojnë nga njëri-tjetri dhe mbështesin njëri-tjetrin në zhvillimin e procedurave të nevojshme për të përmbushur kërkesat e EUAV dhe për të ndërtuar kapacitetet organizative.

Pas krijimit të grupit drejtues të projektit, Caritas Kosova ka marrë pjesë në baza mujore në të gjitha takimet online të organizuara dhe ka pasur mundësinë që vazhdimisht të azhurnohet me progresin e vazhdueshëm si dhe në hapat e ardhshëm me partnerët tjerë të përfshirë në projekt. Gjatë vitit 2021 është krijuar sistemi i përcjelljes financiare dhe po përditësohet vazhdimisht. Përmes platformës Baobab, stafi i projektit ka shkëmbyer përvojat, materialet dhe dokumentet e ndryshme duke ngritur kështu njohuritë mbi praktikat tjera. Po ashtu, anëtarët e stafit të CK-së morën pjesë në trajnimin e prezantimit të mjeteve të tjera të cilat u vunë në dispozicion nga projekti.

ABC-EUAV është projekt rajonal dhe ka në plan takime të përbashkëta të cilat për shkak të pandemisë nuk janë

realizuar. Për këtë arsye, shumica e aktiviteteve të trajnimeve fizike janë organizuar përmes platformave online, përfshirë këtu takimi për rishikimin afatmesëm të projektit i cili u organizua online.

Të gjithë partnerët në projekt patën mundësinë të përditësohen për vitin e dytë të ecurisë së projektit dhe ndryshimin e sistemit të punës së aktiviteteve.



Partner: Bashkimi Evropian





## Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19

Caritas Kosova ka luajtur rol të rëndësishëm në orfimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për kategoritë e cenushme, sidomos për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar, edhe gjatë periudhës së pandemisë.

Që nga fillimi i zbatimit të projektit, janë themeluar pesë qendra rajonale të linjës ndihmëse, që mbulojnë pesë rajone në Kosovë, në të cilat zbatohet projekti. Në këto linja ndihmëse janë angazhuar: një koordinator nacional, pesë koordinator lokal dhe 32 vullnetarë.

Për ti paraprirë shërbimeve në linjat ndihmëse, fillimisht janë organizuar katër trajnime/workshope për programin e ngritjes së kapaciteteve për vullnetarët dhe koordinatorët rajonalë në lidhje me “Ndihmën e Parë Psikologjike në distancë gjatë pandemisë Covid-19”. Që nga fillimi i shërbimeve të ndihmës së parë psikologjike dhe psikosociale në distancë, janë regjistruar rreth 477 telefonata. Shumica dërrmuese e telefonatave janë regjistruar nga përfitues të moshës mbi 50 vjeç, ndërsa është identifikuar një numër më i vogël i personave aftësi të kufizuar.

Më shumë se 91% e telefonatave janë bërë në lidhje me informacionin Covid-19, ndërsa janë referuar edhe për shërbime të specializuara.

Në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe sipas standardeve të OBSH-së, Qendrave për Punë Sociale dhe Kryqit të Kuq, është përcaktuar përmbajtja e pakos së ushqimit dhe higjienës për 1000 përfitues në 5 komuna të Kosovës. Në lidhje me pakot, Caritas Kosova ka shpallur

thirrjen publike në fund të vitit 2021 dhe ka bërë përzgjedhjen e furnizuesit, ndërsa pakot do të zhpërndahen në vitin 2022.



Caritas Kosova në mënyrë të vazhdueshme ka ndarë informacionet në lidhje me këtë projekt me akterë relevant, përfshirë këtu Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Divizioni për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe mbi 55 shoqata, qendra burimore dhe organizata tjera që veprojnë në këtë fushë.

*Partnerët: Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Red Cross-Serbi*





## CONEX

Në përgjithësi, situata e pandemisë Covid-19 në Kosovë u shoqërua me nivele të shtuara të frikës dhe ankthit në nivel individual dhe shoqëror. Kjo erdhi si pasojë e informacioneve të pamjaftueshme për virusin, kërkesave strikte për respektimin e masave mbrojtëse dhe kufizimit të lëvizjes, si dhe dyshimi për efikasitetin e sistemit shëndetësor.

Situata pandemike ka prekur grupet më të marginalizuara, kryesisht të moshuarit, gratë e papuna dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto kategori përveç problemeve shëndetësore po përballen edhe me vështirësi ekonomike. Në këtë drejtim, projekti Conex është fokusuar në trajtimin e nevojave bazë që janë: mungesa e ushqimit, medikamenteve

dhe furnizimeve të tjera thelbësore, përqendrimi i kushteve ekonomike, si dhe izolimi dhe mungesa e aksesit në shërbimet sociale.

Duke pasur parasysh këtë, objektivi i përgjithshëm i projektit Conex është: "Të kontribuojë dhe të lehtësojë pasojat humanitare dhe socio-ekonomike të krizës së shkaktuar nga Covid-19, duke i kushtuar vëmendje të veçantë personave të moshuar, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit si kategoria më e marginalizuar në vend".

Caritas Kosova në partneritet me Shoqatën Nënë Tereza, po sigurojnë zbatimin cilësor të aktiviteteve të projektit në Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë.





Gjatë vitit 2021, Caritas Kosova ka iniciuar procedurat e tenderit të hapur për blerjen e 538 pakove që përmbajnë artikuj ushqimorë dhe jo ushqimorë. Këto procedura të hapura tenderimi janë finalizuar në fund të vitit dhe shpërndarja e paketave do të fillojë në fillim të vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe stafi i projektit ka takuar Qendrat për Mirëqenie Sociale në qytetet respektive për t'i informuar me projektin dhe për të kërkuar ndihmë nëse është e nevojshme gjatë procesit të shpërndarjes.

Në kuadër të projektit, gjatë vitit 2021, 2 ekipe të Home Care kanë ofruar shërbime sociale dhe shëndetësore përmes vizitave në shtëpi. Në total, 4 infermiere të 2 ekipeve të Home Care, kanë shërbyer më shumë se 200 përfitues, ku në 3313 vizita kanë ofruar 21130 shërbime.

Në mënyrë që komponenta e mbështetjes ekonomike në projekt, të zbatohet në mënyrën më të mirë, stafi i Conex ka takuar organizatat e grave në qytetet respektive për të kërkuar mbështetjen e tyre në shkëmbimin e informacionit dhe për të inkurajuar gratë të marrin pjesë në aktivitetet e projektit. Në vijim të kësaj Caritas Kosova ka zhvilluar kriteret e pjesëmarrjes dhe ka publikuar ftesën për dorëzimin e aplikacioneve nga gratë.




Partnerët: Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Caritas Austria, Care, Diakonie, Kryqi i Kuq Austriak

## Buxheti Vjetor 2021

4,238,564 €


1	Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulatore	2,998,567 €
2	Bamirësia dhe Solidariteti	19,920 €
3	SOCIETIES	69,275 €
4	Stop and Help	29,955 €
5	Kuzhina për të varfër	62,500 €
6	ELBA	5,713 €
7	Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës	5,160 €
8	YourJob	230,000 €
9	Kopshti Engjujt	342,476 €
10	My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm	73,105 €
11	Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	104,962 €
12	Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19	103,084 €
13	CONEX	82,688 €
14	ODSS	14,482 €
15	Tjera	96,677 €

## Përqindja sipas Projekteve



Home Care/Përkujdesi Shtëpiak & Mbështetja e Shërbimeve Ambulatore	70,74%
Bamirësia dhe Solidariteti	0,47%
SOCIETIES	1,63%
Stop and Help	0,71%
Kuzhina për të varfër	1,47%
ELBA	0,13%
Fuqizimi i të rinjve dhe grave drejt punësimit në rajonin e Ferizajt dhe Mitrovicës	0,12%
YourJob	5,43%
Kopshti Engjujt	8,08%
My Right - Qendra e Edukimit të Hershëm	1,72%
Përfshirja sociale e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian	2,48%
Forcimi i qëndrueshmërisë së personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar gjatë Covid-19	2,43%
CONEX	1,95%
ODSS	0,34%
Tjera	2,28%

## Përqindja sipas Donatorëve



Rrjeti Caritas	0,96%
----------------	-------

Institucionet Qendrore dhe Lokale	80,95%
-----------------------------------	--------

Institucionet dhe Organizatat ndërkombëtare	12,92%
---	--------

Bashkimi Evropian	1,63%
-------------------	-------

Tjera	3,54%
-------	-------

### Zyra Qendrore - Ferizaj

Rr. Shën Nënë Tereza Nr. 3/Kisha Katolike  
70000 Ferizaj, Kosovë  
Email: [info@caritaskosova.org](mailto:info@caritaskosova.org)  
Tel: +383 (0) 290 328 110

### Zyra Regjionale - Prizren

Adresa: Rr. Papa Gjon Pali II Nr. 1  
20000, Prizren, Kosovë

### Zyra Regjionale - Gjakovë

Adresa: Rr. Ali Ibra p.n./Qendra e Komuniteteve  
50000, Gjakovë, Kosovë

### Zyra Regjionale - Prishtinë

Adresa: Rr. Karposh Nr. 41/Kisha Katolike,  
10000, Ulpianë, Prishtinë, Kosovë

### Zyra Regjionale - Mitrovicë

Adresa: Rr. Perandori Dushan  
p.n./ndërtesa e IBCM  
40000, Mitrovicë, Kosovë

### Zyra Regjionale - Leposaviq

Adresa: Rr. Rudarska, p.n.  
43500, Leposaviq, Kosovë

[www.caritaskosova.org](http://www.caritaskosova.org)